

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.19/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), nenit 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144. Dhe nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018, mori këtë:

V E N D I M

FORMIMI I KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

1. Formohet komisioni për vlerësues e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ky komision ku mandati i tij do të zgjatë sa mandati i Kuvendit.
2. Ky komision përbëhet nga këta anëtarët:
 1. z. Selidin Bytyçi, nga radhët e LDK-së kryesuese,
 2. znj. Jehona Haxhijaj, nga radhët e AAK-së anëtare,
 3. znj. Mirushe Sadikaj, nga radhët e PDK-së anëtare,
 4. znj. Valbona Kalijani, nga shoqëria civile anëtare,
 5. z. Jashar Blakaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik,
 6. z. Enver Rugova, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike,
 7. z. Isa Hoxhaj, Drejtor i Drejtoratit për Urbanizem Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Komisioni i cekur do të bëjë hapjen e të gjitha ofertave të kompanive të cilat ofertojnë për marrjen e pronave komunale në shfrytëzim, do të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave ekonomikisht më të favorshme të ofertuesve të cilët kanë konkurrar do t'i zbatojë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me dhënien e patundshmërive përmes ankandit publik të përcaktuara në Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144 dhe Rregulloren e QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera të cilat janë në natyrën e komisionit.
4. Të gjitha punët administrativo-juridike dhe përkrahjen për Komisionin do t'i kryejë Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në ueb faqen e komunës, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Qaush Balaj

(Signature)



UVI 3-REPUBLIKA E KOSOVES
 ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK
 ADMINISTRATES PËRQJITIISHVE
 KAVA GPSTE ADMINISTRACIJE
 Nr. 01-039-3 Data 05.04.2018
 Br. Istog-Istok